

	Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizren "UKSHIN HOTI"
Pranuar më datë	01.09.2022
Zyra e pranimit	Nr. i protokollit
308	01-381A



## UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000  
Prizren, Republika e Kosovës  
[www.uni-prizren.com](http://www.uni-prizren.com)

# RREGULLORE PËR TË ARDHURA PERSONALE TË PERSONELIT AKADEMIK, SHITESAT PËR FUNKSIONE, MBINORMAT, HONORARËT DHE KOMISIONET NË UNIVERSITETIN "UKSHIN HOTI" PRIZREN

Prizren, 2022



Mbështetur në dispozitat e nenit 23, paragrafi 1.6, nënparagrafi 1.6.2, të Statutit të Universitetit, Këshilli Drejtues i Universitetit “Ukshin Hoti” Prizren, në mbledhjen e mbajtur më datë: 29.07.2022, miraton këtë:

**Rregullore për të ardhura personale të personelit akademik, shtesat për funksione, mbinormat, honorarët dhe komisionet në Universitetin “Ukshin Hoti” Prizren**

**I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

1. Mjetet për të ardhurat personale shfrytëzohen nga fondi i Buxhetit të Kosovës. Nga ky fond paguhen të ardhurat personale dhe kompensimet e tjera për personelin akademik dhe jo akademik në marrëdhënie të rregullt pune, puna mbi normë dhe puna me honorar për personelin akademik të rregullt dhe të angazhuar – bashkëpunëtorët e jashtëm në Universitetin “Ukshin Hoti” (në tekstin e mëtejme Universiteti).
2. Lartësia e të ardhurave personale caktohet në bazë të koeficienteve dhe thirrjeve të koduara në shërbimin qendror për të ardhurat sipas kodimit unik për tërë arsimin në Kosovë.

**II. DISPOZITAT E VEÇANTA**

**Neni 2**

1. Shërbimi për financa dhe zyra e personelit të Universitetit e bënë përlllogaritjen e të ardhurave personale dhe pagesave të tjera në bazë të vendimit të Senatit të Universitetit për angazhimin e personelit akademik për çdo vit akademik, përkatësisht raporteve të dorëzuara deri më datën 5 të muajit vijues. Mbi këtë bazë, menaxhmenti, përkatësisht personi i autorizuar jep urdhër për realizimin e pagesave sipas kontratave të cilat lidhen me të punësuarin me rastin e angazhimit të bashkëpunëtorëve të jashtëm dhe mbi normave për stafin e rregullt akademik.

**Neni 3**

1. Me personelin akademik në marrëdhënie të rregullt pune në Universitetin “Ukshin Hoti”, në pajtim me dispozitat ligjore lidhet kontratë pune:
  - Me normë të plotë,
  - Me gjysmënormë,
  - Mbinormë, dhe
  - Me honorar.
2. Universiteti “Ukshin Hoti”, sipas marrëveshjes, lidh kontratë me bashkëpunëtorë të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime.



#### **Neni 4**

1. Personelit akademik që i ka skaduar kontrata e punës (kategorisë së mësimdhënësve sipas nenit 172 dhe 173 të Statutit në kohëzgjatje prej 4 vjetësh, asistentëve dhe lektorëve sipas nenit 174 dhe 175 të Statutit në kohëzgjatje prej 3 vjetësh) si pasojë e shtyrjes, anulimit përkatësisht vonesave në përfundimin e procedurave të rizgjedhjes apo avancimit, të njëjtëve u vazhdohet kontrata në thirrjen aktuale deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga ana e Senatit lidhur me konkursin në proces.

#### **Neni 5**

1. Personeli në marrëdhënie të rregullt pune në Universitet (akademik), nuk mund të ketë marrëdhënie tjetër të rregullt të punësimit me normë të plotë në ndonjë universitet apo institucion tjetër.

#### **Neni 6**

1. Personeli akademik në marrëdhënie të rregullt pune në Universitetin "Ukshin Hoti" mund të angazhohet me honorar (mësimdhënie), në institucione të tjera, pasi që më parë të ketë marrë pëlqim nga dekani dhe miratim nga rektori.

2. Personeli akademik që ka mbi normë në Universitetin "Ukshin Hoti", nuk mund të ketë kontratë me honorar në mësimdhënie në Institucione tjera.

3. Asnjë anëtar i personelit akademik nuk mund të ketë kontratë për mësimdhënie me honorar në më shumë se në një (1) institucion tjetër publik/ privat në të njëjtën kohë.

### **III SANKSIONET**

#### **Neni 7**


1. Personeli akademik i rregullt dhe bashkëpunëtor i jashtëm, të cilët mungojnë nga procesi mësimor, mbajtja e provimeve, konsultimeve me studentë dhe kujdestarisë do të sanksionohet me heqjen e dyfishit të pagesës për orë të humbur (për profesorë: 1 (një) orë mësimi 50 €, kurse për ligjërues dhe lektor 1 (një) orë 30 €), si dhe për asistent 1 (një) orë 26 €.

2. Dekani i njesisë akademike obligohet të zbatojë sanksionet e përcaktuara sipas paragrafit 1 të këtij neni. Nëse Dekani nuk raporton për orët e humbura ose për mos mbajtjen e provimit, do të sanksionohet me 50% të vlerës së shtesës funksionale.

### **IV PERSONELI AKADEMIK**

#### **Neni 8**

1. Për personelin akademik në marrëdhënie të rregullt pune në Universitet përcaktohet norma minimale e orëve javore të mësimit, numrit të temave të mentoruara të studimeve themelore dhe të masterit dhe lartësia e pagës sipas titujve akademik si në vijim:



1.1. Kompensimi i personelit akademik me normë të plotë të punës:

Tabela 1.

Nr	Titulli akademik	Orë në javë	Paga mujore në vlerë monetare në euro
1	Profesor i rregullt	6 orë në javë	1,486.72
2	Profesor i asocuar	6 orë në javë	1334.67
3	Profesorët asistent	6 orë në javë	1182.62
4	Ligjërues	6 orë në javë	1030.57
5	Lektor	10 orë në javë	878.52
6	Korepetitorë	10 orë në javë	878.52
7	Asistent	10 orë në javë	803.40

- 1.2. Asistentit në marrëdhënie të rregullt pune, me gradë doktor shkence i shtohet edhe një pagesë në lartësi prej 100 € mbi pagën bazë.
- 1.3. Nëse mësimdhënësit në marrëdhënie të rregullt pune nuk mund t'i plotësohet norma e plotë e orëve të ligjëratave, atë mund ta plotësojë edhe me orë të ushtrimeve në përpjesëtim 1 me 1, por jo më shumë se 50% nga tërësia e normës brenda një semestri.
- 1.4. Dekani i Njesisë akademike mund t'i lejojë pagesë të orëve mbi normë të ushtrimeve në proporcion 2 orë ushtrime ekuivalent me 1 orë ligjërata (Në rast se profesorit i ndahen orët me numër tek, atëherë atë orë e mbanë pa pagesë), kjo dispozitë vlen edhe për bashkëpunëtorët e jashtëm.
- 1.5. Mësimdhënësit në marrëdhënie të rregullt pune që nuk kanë fondin e plotë të orëve për normë sipas paragrafit 1 dhe nënparagrafi 1.1 të këtij neni në njërin nga dy semestrat e vitit akademik, atë mund ta plotësojnë me orët nga mbi norma e semestrit tjetër, por jo më shumë se gjysmën e normës së paraparë me paragrafin 1 dhe nënparagrafi 1.1 tabela 1.
- 1.6. Norma dhe mbinorma mund të realizohet edhe në njësi të tjera akademike brenda Universitetit.
- 1.7. Orët mbinormë nuk mund të barten prej një semestri në semestrin tjetër.
- 1.8. Dekani i njesisë akademike obligohet që të zbatojë dispozitat e përcaktuara sipas këtij neni. Nëse dekani nuk raporton për moszbatimin këtij neni dhe pa arsyetim të bazuar lejon kompensimin sipas këtij neni, do të sanksionohet me 50% të vlerës së shtesës funksionale.



1.9. Numri i mentorimeve të punimeve të diplomës në studime themelore (Baçelor), me pagesë, bëhet sipas specifikave të njësive akademike të përcaktuara në tabelën nr 2 brenda vitit kalendarik.

**Tabela 2.**

Njësia Akademike/Fakulteti	Mentor	Kryetar	Anëtar
Juridik	10	15	15
Ekonomik	12	15	15
Shkencave të Jetës dhe Mjedisit	10	15	15
Filologjisë	12	15	15
Edukimit	12	15	15
Shkencat Kompjuterike	12	15	15

1.10. Numri i mentorimeve të punimeve të diplomës në studime Master, me pagesë, bëhet sipas specifikave të njësive akademike të përcaktuara në tabelën nr 3.

**Tabela 3.**

Njësia Akademike/Fakulteti	Mentor	Kryetar	Anëtar
Juridik	10	15	15
Ekonomik	12	15	15
Shkencave të Jetës dhe Mjedisit	10	15	15
Filologjisë	10	15	15
Edukimit	10	15	15
Shkencat Kompjuterike	10	15	15



## V. KOMPENSIMI FUNKSIONAL SIPAS POSTEVE UDHËHEQËSE

### Neni 9

1. Personeli akademik i emëruar apo i zgjedhur në njërin prej posteve udhëheqëse të përcaktuar si në paragrafin 2 të këtij neni, pagën bazë do ta marrë në përputhje me thirrjen akademike që bart.

2. Personeli i rregullt akademik i Universitetit i zgjedhur apo emëruar në pozita tjera udhëheqëse në insitucione tjera mund të mbajë deri në 6 orë honorar, nëse i njëjti ska mbinormë në Institucione tjera (Orët mund t'i ndahen me vendim të Këshillit dhe Dekanit të njësisë akademike sipas nevojave të njësisë akademike pa procedura të konkursit).

3. Personelit akademik, i emëruar apo i zgjedhur në njërin prej posteve udhëheqëse të përcaktuar si më poshtë, në përputhje me këtë rregullore, i takon shtesa mujore mbi pagën bazë si në vijim:

**Tabela 4.**

Nr. rendor	Emërtimi i pozitës	Paga bazë	Shtesa
1	Rektor	Në bazë të thirrjes akademike	550.00 €
2	Prorektor	Në bazë të thirrjes akademike	450.00 €
3	Dekan i fakultetit	Në bazë të thirrjes akademike	350.00 €
4	Prodekan i fakultetit	Në bazë të thirrjes akademike	250.00 €
5	Profesor emeritus	Në bazë të thirrjes akademike	250.00 €
6	Këshilltar i rektorit	Në bazë të thirrjes akademike	200.00 €
7	Koordinator për shkencë dhe projekte	Në bazë të thirrjes akademike	200.00 €
8	Shef i departamentit (programit)	Në bazë të thirrjes akademike	100.00 €
9	Drejtor i Institutit	Në bazë të thirrjes akademike	120.00 €
10	Sekretar i institutit	Në bazë të thirrjes akademike	70.00 €
11	Trajnerët e qendrës profesionale dhe institutit për orë trajnimi	Në bazë të thirrjes akademike	25.00 €
12	Anëtar i Senatit, i cili nuk merr shtesa Funktionale		70.00 €



4. Shtesat funksionale për anëtarët e Këshillit Drejtues përcaktohen me Udhëzim Administrativ të MASHTI-it.

## **VI. KOMPENSIMI PËR ORËT E MBAJTURA MBI NORMË PËR PERSONELIN AKADEMIK NË MARRËDHËNIE TË RREGULLT PUNE**

### **Neni 10**

1. Personeli akademik në marrëdhënie të rregullt pune në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren, në përputhje me këtë rregullore, i takon kompensimi për orët e mbajtura mbi normë, si më poshtë:

**Tabela 5.**

Nr.	Emërtimi i thirrjes	Vlera në bruto
1	Për profesorët e Universitetit (Prof. i rregullt, prof. asoc dhe prof ass)	25.00 €
2	Për ligjërues, lektor	15.00 €
3	Korepetitorë, asistent	13.00€

2. Personeli akademik i cili në momentin e plotësimit të moshës mandatore të pensionimit ka qenë në marrëdhënie pune në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren, me rastin e angazhimit pas pensionimit i takon kompensimi për çdo orë të mbajtur, si në paragrafin 1 të këtij neni.

3. Personeli akademik në marrëdhënie të rregullt, në përputhje me këtë rregullore, pagesa nga paragrafi (1) dhe (2) i tabelës 4 të këtij neni i takon më së shumti për 8 (tetë) muaj brenda vitit akademik dhe atë duke filluar nga 1 tetori deri më 15 janar dhe 16 shkurt deri më 31 maj të të njëjtit vit akademik.

## **VII. KOMPENSIMI PËR ORËT E MBAJTURA PËR BASHKËPUNËTORËT E JASHTËM – TË ANGAZHUARIT**

### **Neni 11**

1. Bashkëpunëtorit të jashtëm – të angazhuarit, në përputhje me këtë rregullore, i takon kompensimi për orët e mbajtura, si më poshtë:

**Tabela 6.**

Nr	Emërtimi i thirrjes	Vlera në bruto
1	Bashkëpunëtorë – të angazhuar për ligjërata (pa thirrje akademike në universitete publike)	15.00 €



2	Bashkëpunëtorë – të angazhuar për ushtrime (pa thirrje akademike në universitete publike)	13.00 €
3	Për profesorët jashtë UUHP-së por me tituj të barasvlershëm në universitete publike	25.00 €
4	Për profesorët nga universitetet e rajonit të cilët janë mësimdhënës në Gjuhën Boshnjake dhe kanë gradën dr.sc dhe kanë thirrje akademike e që nuk e kanë të nostrifikuar thirrjen akademike në Kosovë. Thirrja akademike e tyre përshkruhet si ligjërues <sup>1</sup> .	25.00 €

2. Bashkëpunëtorit të jashtëm – të angazhuarit, në përputhje me këtë rregullore nga paragrafi (1), (2), (3) dhe (4) i tabelës 5 të këtij neni, kontrata e punës lidhet duke filluar nga 1 tetori deri më 15janar dhe 16shkurt deri më 31 maj, të të njëjtit vit akademik.

3. Në raste të mungesës së bashkëpunëtorëve të jashtëm me gradë adekuate, në përputhje me rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm, për ligjërata në nivelin bachelor mund të angazhohen edhe kandidatët me gradën e Magjistratit (Mr.Sc.) ose Masterit (MA).

4. Paga për kategorinë nga paragrafi 3 i këtij neni bëhet si për bashkëpunëtor – të angazhuar për ushtrime.

## **VIII. KOMPENSIMI PËR ORËT E MBAJTURA MBI NORMË PËR ORGANET DREJTUESE TË UNIVERSITETIT DHE NJËSIVE AKADEMIKE**

### **Neni 12**


1. Rektori i Universitetit nuk është i obliguar të mbajë ligjërata për realizimin e normës së paraparë sipas thirrjes akademike që mban, ndërsa mund t'i mbajë deri në 6 (gjashtë) orë në kuadër të mbi normës.

2. Prorektori, anëtari i Këshillit Drejtues i zgjedhur nga Senati, Dekani nuk është i obliguar të mbajë ligjërata për realizimin e normës së paraparë sipas thirrjes akademike që mban, ndërsa mund t'i mbajë deri në 6 (gjashtë) orë në kuadër të mbi normës.

3. Prodekanët, kanë për obligim të mbajnë 3 (tri) orë të normës së paraparë sipas thirrjes akademike që mbajnë, ndërsa mund t'i mbajnë deri në 6 (gjashtë) orë në kuadër të mbi normës.

<sup>1</sup> Kjo pikë është hartuar në përputhje me vendimin e datës 08.01.2020 me nr ref 01-04 të Këshillit Drejtues.





## **IX. FONDI I ORËVE MBI NORMË PËR PERSONELIN AKADEMIK NË MARRËDHËNIE TË RREGULLT PUNE**

### **Neni 13**

1. Personeli akademik i Universitetit në marrëdhënie të rregullt pune (Profesor i Rregullt, Profesor i Asocuar, Dr. Profesor Asistent, Dr. dhe Ligjërues ) mund të mbajnë deri në 6 orë mbi normë në javë.
2. Asistenti, lektori dhe korepetitori i Universitetit në marrëdhënie të rregullt pune mund të mbajnë deri në 8 orë mbi normë në javë.
3. Personeli administrativ i universitetit nuk ka të drejtë të angazhohet në procesin mësimor në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren.
4. Për personelin akademik të paraparë me paragrafin (1) të këtij neni, në mungesë të normës së plotë, plotësimi i normës bëhet edhe me orë të cilat do t'i mbajnë në njësitë tjera akademike brenda Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren.
5. Për personelin akademik, Dekani i njësisë akademike është e obliguar që të sigurojë orë mësimore deri në normë të plotë. Në rastin kur mësimdhënësit i ofrohen orë për plotësimin e normës dhe ai nuk e pranon, pagesa i bëhet proporcionalisht me numrin e orëve të cilat i mban.
6. Orët mbi normë nuk mund t'i jepen personelit akademik i cili e ka normën e plotë, për derisa nuk i plotësohet norma e plotë mësimdhënësve përkatësisht asistentëve në marrëdhënie të rregullt pune nga lëmi i njëjtë apo e përafërt.
7. Asistentëve të rregullt nuk mund t'iu kompensohen orët e ligjëratave. Përjashtimisht asistenti që është rizgjedhur, në mungesë të profesorit për lëndën, mund të autorizohet për mbajtjen e ligjëratave të kufizuara në studimet bachelor me autorizimin e Këshillit të njësisë akademike dhe nën mbikëqyrjen e një mësimdhënësi nga departamenti - katedra.
8. Angazhimi i personelit akademik me orë mbi normë dhe me honorar në Universitet bëhet në bazë të vendimit të Senatit të Universitetit me propozim të njësisë akademike.

## **X. FONDI I ORËVE PËR BASHKËPUNËTORËT E JASHTËM – TË ANGAZHUARIT**

### **Neni 14**

1. Bashkëpunëtorët e jashtëm – të angazhuarit dhe profesorët jashtë Universitetit por me tituj të barasvlershëm në universitete publike për ligjërata mund të mbajnë deri në 6 orë në javë. Përjashtimisht nga kjo pikë për ligjëruesit e angazhuar në gjuhën turke dhe boshnjake mund të mbajnë deri në 8 orë në javë. Për profesorët sipas nenit 11 pika 4 e tabelës të cilët mund të mbajnë 6 orë në javë.



2. Bashkëpunëtorë – të angazhuar për ushtrime (pa thirrje akademike në universitete publike) mund të mbajnë deri në 8 orë në javë.

## XI. KRITERET THEMELORE PËR FORMIMIN E GRUPEVE TË STUDENTËVE

### Neni 15

Përcaktimi i grupeve të studentëve në studimet baçelor dhe master bëhet duke u bazuar në tabelën vijuese:

**Tabela 7.**

Fakultete	Ligjërata obligative	Ligjërata zgjedhore	Ushtrimet për lëndët obligative / zgjedhore
F. Juridik	Deri 60	Min. 20 – deri 60	Deri 30
F. Ekonomik	Deri 60	Min. 20 – deri 60	Deri 30
F. Edukimit	Deri 60	Min. 10 – deri 60	Deri 30
F. Filologjik	Deri 60	Min. 10 – deri 60	Deri 30
F. Shkencave Kompjuterike	Deri 60	Min. 10 – deri 60	Deri 15
F. Shkencave të Jetës	Deri 60	Min. 10 – deri 60	Deri 10

Nëse tejkalohet numri maksimal (deri) sipas tabelës nr. 7, atëherë formohet grupi i ri.

## XII. LARTËSIA E KOMPENSIMIT PËR PUNIM TË DIPLOMËS NË STUDIMET BACHELOR DHE NË STUDIMET MASTER

### Neni 16

1. Mësimdhënësit i takon kompensimi për çdo punim diplome të nivelit të studimeve baçelor, mbi numrin e përcaktuar me tabelën nr. 2 të nenit 8, si në vijim:

**Tabela 8.**

Nr. Rendor	Emërtimi i komisionit	Kompensimi
1	Mentori	30.00 €
3	Kryetari i Komisionit	20.00 €



2	Anëtari (ët) e komisionit	15.00 €
---	---------------------------	---------

2. Mësimdhënësit i takon kompensimi për çdo punim diplome të nivelit të studimeve Master, mbi numrin e përcaktuar me tabelën nr. 3 të nenit 8, si në vijim:

**Tabela 9.**

Nr. Rendor	Emërtimi i komisionit	Kompensimi
1	Mentori	150.00 €
2	Kryetari i Komisionit	50.00 €
3	Anëtari (ët) e komisionit	30.00 €

3. Mentori si në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni nuk kompensohet edhe në cilësi të anëtarit të komisionit.

### **XIII. MËNYRA E REALIZIMIT, VERIFIKIMIT DHE MONITORIMIT TË PAGESAVE PËR ORËT E RREGULLTA, ORËT MBI NORMË DHE ANGAZHIMEVE TË TJERA**

#### **Neni 17**

1. Çdo orë e mbajtur arsyetohet me listat e nënshkruara nga studentët e pranishëm, të verifikuara dhe nënshkruara nga personi i autorizuar i fakultetit.
2. Orët e mbajtura nga personeli akademik i pensionuar, bashkëpunëtorët e jashtëm dhe orët mbi normë të personelit të rregullt kompensohen në muajin vijues.
3. Raportet e nënshkruara dorëzohen për pagesë në shërbimin e financave të njësisë akademike përkatëse deri më datën 5 të muajit vijues. Raportet për orët e mbajtura më të vjetra se një muaj nuk paguhen, përveç rasteve kur në muajin përkatës nuk ka mjete buxhetore, atëherë pagesa mund të shtyhet për realizim në muajt vijues.
4. Në rast se pa arsye personeli akademik dhe menaxhmenti nuk dorëzon raportin e orëve të mbajtura deri me datën 5 të muajit vijues, përgjegjësia për mos realizim të pagesave do të bjerë mbi ta.



#### **XIV. LARTËSIA E KOMPENSIMIT PËR ORËT E MBAJTURA NË STUDIME TË DOKTORATËS**

##### **Neni 18**

1. Numri i kandidatëve që mund t'i mentorojë një profesor, përcaktohet me Rregullore për studimet e doktoratës.

2. Kompensimi për mësim në studimet e doktoratës bëhet Rregullore për studimet e doktoratës.

2.1. Kompensimi për orët e mbajtura për grupin e kurseve të përgjithshme ---- 40.00 € për një (1) orë ligjërata, por jo më shumë se 28 orë për semestër.

2.2. Kompensimi për orët e mbajtura për grupin e kurseve profesionale është --- 40.00 € për një (1) orë ligjërata, por jo më shumë se 12 orë për semestër.

3. Kompensimi i profesorëve të cilët mbajnë ligjërata në studime të doktoratës bëhet me kontratë të veçantë.

#### **XV. LARTËSIA E KOMPENSIMIT PËR ORËT E MBAJTURA NË STUDIME TË DOKTORATËS**

##### **Neni 19**

1. Kompensimi për mentorim dhe komisionet e doktoratës bëhet si në vijim:

**Tabela 10.**

<b>Nr</b>	<b>Emërtimi i komisionit</b>	<b>Kompensimi</b>
1	Për mentorin e temës së doktoratës	1200.00 €
2	Për kryetar të komisionit për vlerësim dhe mbrojtje të temës	300.00 €
3	Për anëtar të komisionit për vlerësim të temës së doktoratës	200.00 €
4	Për anëtar të komisionit për mbrojtje të temës së doktoratës	200.00 €
5	Për anëtar të jashtëm të komisionit për vlerësim dhe mbrojtje të temës së doktoratës	300.00 €

2. Për anëtarët e jashtëm si pjesë e Komisionit për mbrojtjen e punimit të doktoratës në Universitetin "Ukshin Hoti", shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit i kompenson Universiteti "Ukshin Hoti".



## **XVI. LARTËSIA E KOMPENSIMIT PËR KOMISIONIN RECENSUES**

### **Neni 20**

1. Kompensimi për komisionin recensues do të bëhet si në vijim (brendshëm):

- 1.1. Kryetari i komisionit ----- 50.00 €.
- 1.2. Anëtari i komisionit ----- 30.00 €.

2. Kompensimi për komisionin recensues do të bëhet si në vijim (Jashtë Universitetit "Ukshin Hoti):

- 1.1. Kryetari i komisionit ----- 80.00 €.
- 1.2. Anëtari i komisionit ----- 50.00 €.

## **XVII. LARTËSIA E KOMPENSIMIT PËR KOMISIONET E PËRHERSHME TË SENATIT**

### **Neni 21**

1. Kompensimi i komisioneve të Senatit bëhet si në vijim :

- 1.1. Komisioni i studimeve në nivel Universiteti ----- 30.00 €.
- 1.2. Komisioni i ankesave i themeluar nga Senati<sup>2</sup>----- 25.00 €.
- 1.3. Komisioni i Etikës në nivel Universiteti ----- 25.00 €.
- 1.4. Komisioni për Hartimin e RRV-së ----- 25.00 €.
- 1.5. Komisioni Statutar ----- 25.00 €.
- 1.6. Komisioni i Cilësisë ----- 25.00 €.

2. Kompensimi i komisioneve të parapara me paragrafin (1) të këtij neni bëhet në bazë të mbledhjeve të mbajtura, po jo më shumë se për dy mbledhje në muaj. Përfundim nga kjo, për komisionin e studimeve i cili gjatë fazës së konkurseve për shkak të shtimit të vëllimit të punëve për zgjedhjen, avancimin dhe rizgjedhjen e personelit do të kompensohet deri në katër mbledhje në muaj.

3. Kryetari i komisionit jo më larg se 5 ditë prej përfundimit të takimit dërgon listën e nënshkrimeve dhe pagesën tek prorektori për Buxhet, Financa dhe Infrastrukturë.

4. Kompensimi i senatorëve bëhet si shtesë për çdo muaj me vlerën sipas kësaj rregullore.

5. Sekretarit të universitetit nuk i takon shtesa funksionale për pjesëmarrje në Senat.

<sup>2</sup> Përfshin komisionin e përherëshëm në nivel të Universitetit dhe Komisionet ad hoc të ankesave, sipas kërkesave të njësive akademike të themeluara nga Senati.



## XVIII. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

### Neni 22


1. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore në ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues i Universitetit, shfuqizohen të gjitha rregulloret, vendimet apo udhëzimet e tjera të mëparshme të kësaj natyre.

### Neni 23

1. Kjo rregullore hyn në fuqi datën kur miratohet nga Këshilli Drejtues i Universitetit, dhe shfuqizon të gjitha vendimet tjera që kanë lidhje me të ardhurat personale të stafit akademik.

Prof. Asoc. Dr. Arif Murria

Kryesuesi Këshillit Drejtues



I dërgohet:

- Këshillit Drejtues;
- Menaxhmentit;
- Sekretarit të Përgjithshëm;
- Njësive akademike;
- Zyrës ligjore; Zyrës së financave, Zyrës për Çështje Akademike dhe Zyrës së Personelit;
- Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
- Arkivit.